



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1237/ 5 prot.

Datë 12 .05.2026

VENDIM
Nr.630 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.05.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-82305-04-16-2026 me objekt “Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale”, me fond limit 7,454,401.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 28-04-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-82305-04-16-2026 me objekt “Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale”, me fond limit 7,454,401.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 28-04-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Ankimues: Operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” sh.p.k, *NIPT L51819005Q*, dhe adresë: *Rruga Çerçiz Topulli , objekti Nr.17*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër, *Adresa Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 - Shkodër*

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe Rregullat e Prokurimit Publik të ndryshuara.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17-04-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-82305-04-16-2026 me objekt “Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale”, me fond limit 7,454,401.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 28-04-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër..

II.2. Në datën 23.04.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr.1237/2026 protokoli, dhe protokolluar pranë KPP, datë 23.04.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6575, e operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” sh.p.k , me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4 Nëpërmjet shkresës nr. 9575/4 prot., 28.04.2026 (Kthim- përgjigje), protokolluar me tonën me nr. 1237/2026, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, Kthim përgjigje për

shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “ALBDESIGN PSP” sh.p.k. Ku në përfundim të shqyrtimit të saj rezulton se ky i fundit autoriteti kontraktor e ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

Gjithashtu informacioni i sipërcituar është përcjellë dhe më shkresën 9575/5 datë 28.04.2026.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

Nëpërmjet shkresës nr. 9575/4 prot., 28.04.2026 (Kthim- përgjigje), protokolluar me tonën me nr. 1237/2026, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, Kthim përgjigje për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “ALBDESIGN PSP” sh.p.k. Ku në përfundim të shqyrtimit të saj rezulton se ky i fundit autoriteti kontraktor e ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

Gjithashtu informacioni i sipërcituar është përcjellë dhe më shkresën 9575/5 datë 28.04.2026.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës nr. 9575/4 prot., 28.04.2026 (Kthim- përgjigje), protokolluar me tonën me nr. 1237/2026, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, Kthim përgjigje për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “ALBDESIGN PSP” sh.p.k. Ku në përfundim të shqyrtimit të

saj rezulton se ky i fundit autoriteti kontraktor e ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për pjesën e pranuar të ankesës e paraqitur nga operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” sh.p.k dhe të vijojë shqyrtimin për pjesën e tjetër.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik me arsyen se,...[IV. Në shtojcën 8 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit , Kapaciteti teknik të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se: Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt e kërkuar sipas specifikimeve teknike, sipas listës më poshtë: Drejtoria e Turizmit 1-Hartë 2-Guidë 3-Gift box Drejtoria e Sherbimeve Sociale, Strehimit dhe Shendetit Publik 1-Roll up me mekanizëm 2- Shishe termusi e personalizuar 3- Kupë xhami Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit 1-Katalog/Revistë 2-Printime në forex 3-Çantë tekstili Dorëzimi i mostrave të bëhet ditën dhe orën e hapjes së tenderit prane Zyres se Protokollit Bashkia Shkodër, ato duhet të jenë të mbyllura në një zarf/kuti jo transparente të vulosur. Së bashku me mostrat, ofertuesi duhet të bëjë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqesuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti. Mosparaqitja e mostrave është kusht skualifikim. Shënim: Në lidhje me mostrat e kërkuara, nuk është e domosdoshme që të bëhen me logon e Bashkise Shkoder por pranohen edhe me një logo tjetër të çfarëdoshme. Në nenin 40 pika 6 gërma a të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik , i ndryshuar, parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor mund tu kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim si dhe specifikimeve teknike bëhet që t i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses dhe në përputhje me specifikimet teknike të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve parashikuar nga neni 2 dhe 3 i ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik . Zbatimi i parimit të

transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garanci kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe në fazën e vlerësimit të tyre. Në rastin konkret, pasi morëm në shqyrtim dokumentat e tenderit konstatojmë se autoriteti kontraktor ka kërkuar dorëzimin e mostrave: Drejtoria e Turizmit 1-Hartë ; 2-Guidë ; 3-Gift box Drejtoria e Sherbimeve Sociale, Strehimit dhe Shendetit Publik: 1-Roll up me mekanizëm ; 2- Shishe termusi e personalizuar ; 3- Kupë xhami. Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit:1-Katalog/Revistë ; 2-Printime në forex ; 3-Çantë tekstili . Gjithashtu, në vijim autoriteti kontraktor ka parashikuar specifikimet teknike për artikujt e kërkuara nëpërmjet dokumentave Specifikime Bujqësia , Specifikime teknike kultura , Specifikime teknike turizmi dhe Specifikime teknike sociale . Së pari, në lidhje me sa më sipër, vlerësojmë se autoriteti kontraktor në rast se e konsideron të nevojshme kërkesën për dorëzimin e mostrave duhet të argumentojë domosdoshmërinë e këtij kriteri në rast se vlerësojnë që paraqitja e tyre, i shërben Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për të verifikuar nëse mallrat e ofertuara i plotësojnë specifikimet teknike në dokumentet e tenderit. Në një interpretim literal dhe sistematik të legjislacionit në fuqi konstatojmë se autoriteti kontraktor ka të drejtën të kërkojë dorëzimin e mostrave nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike, por në të njëjtën kohë vlerësojmë se dorëzimi i mostrave duhet të argumentohet. Pra, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi është e përcaktuar shprehimisht rasti kur autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të kërkojë dorëzimin e mostrave, vetëm në rastet kur e gjykon se kjo kërkesë ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në të njëjtën linjë janë edhe rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik në lidhje me kërkesat e autoriteteve kontraktore për dorëzimin e mostrave ku më konkretisht në Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime me Nr.7998 Prot, datë 24.12.2021 ndër të tjera Agjencia e Prokurimit Publik rekomandon: [...Sjellim në vëmendje të autoriteteve/enteteve kontraktore se mund të kërkojnë mostra të mallrave, në rast se vlerësojnë që paraqitja e tyre, i shërben Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për të verifikuar nëse mallrat e ofertuara i plotësojnë specifikimet teknike në dokumentet e tenderit dhe për të vlerësuar në këtë mënyrë ofertën teknike...]. Së dyti, në rast se autoriteti kontraktor e vlerëson të domosdoshme kërkesën për dorëzimin e mostrave, kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e mostrave nga operatorët ekonomikë me qëllimin e verifikimit të kapaciteteve të nevojshme për të prodhuar produktet objekt prokurimi si dhe të verifikimit të përputhshmërisë të mostrave të dorëzuara me specifikimet teknike të dhëna në dokumentet e tenderit, duhet të shoqërohet me filet e modeleve të kërkuara, pasi në shqyrtimin e dokumenteve të tenderit konstatojmë se operatorëve ekonomikë nuk i janë vënë në dispozicion materiale apo skica grafike në të cilat duhet të bazohen për të realizuar mostrat e kërkuara. Sa më sipër, vlerësojmë se specifikimet teknike duhet të përfshijnë edhe modele apo skica grafike të cilat duhet të jenë sa më të sakta dhe të krijojnë ide sa më të qarta të jetë e mundshme në mënyrë të tillë që të mos shkaktojnë konfuzion tek operatorët ekonomikë në momentin e përgatitjes së ofertës dhe në të njëjtën kohë të evitohen hapësirat për interpretim në momentin e vlerësimit. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin Nr.1/2021, datë 29.04.2021 në të cilin është shprehur se: [...për sa kohë në kriterin kualifikues të përcaktuar në Shtojcën 8, pika 2.3.6 të dokumenteve të tenderit është përcaktuar se: Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre me specifikimet teknike është kusht për skualifikim. , për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e mostrave të sipërpërmendura nga ofertuesit është vërtetimi se subjektet ofertuese kanë kapacitetet e nevojshme për të prodhuar produktet objekt prokurimi

sipas specifikimeve teknike të dhëna në dokumentet e tenderit, por nga ana tjetër autoriteti kontraktor referuar përcaktimeve të nenit 23, pika 4, të LPP-së, gjykon se autoriteti kontraktor ka detyrimin që të garantojë ofertuesit që specifikimet teknike (ku përfshihen modele) të jenë të sakta për tu dhënë ofertuesve një ide të qartë për përgatitjen e ofertës, si dhe nga përshkrimi i mallrave objekt prokurimi të dalin edhe kërkesat nga pikëpamja estetike dhe për më tepër të garantohet krahasueshmëria e mostrave të dorëzuara me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor, prandaj në rastin konkret pretendimet e ankimuesve qëndrojnë. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet tu vërë në dispozicion ankimuesve file për shtyp për mostrat e përcaktuara në kërkesën për kualifikim të pikë 2.3.6, të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit...] Në lidhje me sa më sipër, kërkojmë që: ose të hiqet kërkesa për dorëzimin e mostrave të kërkuara në pikën 2.3.8 të Kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit ; ose në rast se autoriteti kontraktor e konsideron të domosdoshme dorëzimin e mostrave për të vërtetuar përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike të parashikuara në dokumentat e tenderit, atëherë autoriteti kontraktor duhet tu vërë në dispozicion operatorëve ekonomikë të interesuar file-t grafike për shtyp për mostrat e përcaktuara në kërkesën për kualifikim të pikë 2.3.8 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit.], Komisioni vë re se,

III.2.1 Autoriteti kontraktor ka parashikuar “Kriteret e veçanta të kualifikimit” në pikën 2.3.8, shtojca 8, **si dhe shtojca 6** e dokumentave standarte të tenderit, kërkesat si në vijim:

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt e kërkuar sipas specifikimeve teknike, sipas listës më poshtë:

Drejtoria e Turizmit

1-Hartë

2-Guidë

3-Gift box

Drejtoria e Sherbimeve Sociale, Strehimit dhe Shendetit Publik

1-Roll up me mekanizëm

2- Shishe termusi e personalizuar

3- Kupë xhami

Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

1-Katalog/Revistë

2-Printime në forex

3-Çantë tekstili

Dorëzimi i mostrave të bëhet ditën dhe orën e hapjes së tenderit pranë Zyres së Protokollit Bashkia Shkodër, ato duhet të jenë të mbyllura në një zarf/kuti jo transparente të vulosur. Së bashku me mostrat, ofertuesi duhet të bëjë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqesuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti. Mosparaqitja e mostrave është kusht skualifikim.

Shënim: Në lidhje me mostrat e kërkuara, nuk është e domosdoshme që të bëhen me logon e Bashkise Shkoder por pranohen edhe me një logo tjetër të çfarëdoshme.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 6 Si dhe në shtojcën 6 ka parashikuar si në vijim specififikimet teknike për artikujt

5. Harta

Operatori duhet të printojë 3 modele hartash për të cilat harta dixhitale e territorit të Shkodrës do të ofrohet nga Drejtoria e Turizmit të Bashkisë Shkodër. Harta të qytetit, Thethit dhe Velipojes 1. Karakteristikat e letrës së hartës. • Dimensio 56 x 80 cm • Letra 130 gram, letra duhet të jetë mat • Botim nga të 2 anët • Ngjyrat 4x4 • Harta e palosur duhet të jetë në dimensionin 9.6 x 18.4 (3x7) Karakteristikat e letrës sëKapakut • Dimensio 10.4 x 38 cm • Letra 350 gram • Botim nga 1 anë • Ngjyrat 4/0 me ngjijtje me hartën • Llakim UV Kapaku duhet të ketë foto nga të dyja anët dhe në foto të respektohet e drejta e autorit, duhet të ketë një design të ri, të rikonceptuar duke vendosur stemën e Bashkisë Shkodër dhe logon e turizmit

6. Guida

Guida turistike do të realizohet në format A5 (148 × 210 mm), me një numër minimal prej 100 faqesh (pa përfshirë kopertinën), dhe do të përmbajë informacion të strukturuar qartë, të shoqëruar me fotografi profesionale me rezolucion të lartë, të përshtatura për shtyp offset. Materiali grafik dhe përmbajtja do të përpunohen sipas standardeve bashkëkohore të botimeve promovuese turistike, me një design profesional dhe të një niveli të lartë estetik e funksional. Faqet e brendshme do të shtypen në letër 130 gr/m² lustër, me shtyp offset 4+2 ngjyra (CMYK), duke garantuar cilësi të lartë riprodhimi dhe qëndrueshmëri të ngjyrave. Kopertina do të realizohet me karton 350 gr/m², me shtyp në të dyja anët (CMYK) dhe plastifikim lustër për mbrojtje dhe rezistencë ndaj konsumimit. Lidhja do të jetë me qepje dhe ngjijtje, për të siguruar qëndrueshmëri dhe përdorim afatgjatë. Operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë pranë Drejtorisë së Turizmit të Bashkisë Shkodër, brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi, minimalisht dy propozime të ndryshme design-i për miratimin e modelit final. I gjithë procesi i realizimit, nga përgatitja grafike deri te shtypi përfundimtar, do të kryhet në koordinim të plotë me Drejtorinë e Turizmit të Bashkisë Shkodër.

8. Gift box “SHKODRA – HERITAGE COLLECTION” është një set dhuratë premium i konceptuar për delegacione zyrtare dhe panairë ndërkombëtare, me fokus të veçantë në prezantimin vizual dhe fotografinë profesionale të qytetit. Seti përbëhet nga një kuti kartoni rigid cilësor (tip bizhuterie), në ngjyrë blu të errët ose jeshile të thellë, me relief të siluetës së Kalasë së Rozafës dhe stampë gold ose argjend, si dhe logo diskrete institucionale. Në brendësi përfshihet një mesazh prezantues në gjuhën angleze. Elementi kryesor i setit është një koleksion prej 8–10 kartolinash premium me fotografi profesionale artistike të atraksioneve kryesore të Shkodrës (Rozafa, Liqeni i Shkodrës, Ura e Mesit, Thethi, arkitekturë tradicionale dhe evente kulturore). Kartolinat realizohen në letër 400 gr, me print matte dhe detaje Spot UV në elemente kryesore, me tekst bilingual (Shqip/Anglisht). Seti plotësohet me një kartë zyrtare mirëseardhjeje dhe element mbyllës premium (magnet ose fjongo sateni). I gjithë produkti synon të perceptohet si një dhuratë institucionale dhe diplomatike me standard të lartë estetik dhe përfaqësues.

3. Roll – Up me mekanizëm

Ideim, Dizënjim dhe printim i Roll up-eve me dimensione 1 x 2 m, me mekanizëm, printim me ngjyra, me rezolucion të lartë në banner 450 gr. Baneri të ketë logo dhe përmbajtje të

përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Ideimi, dizenjimi dhe printimi të realizohet nga operatori ekonomik. Versioni final duhet të diskutohet paraprakisht me autoritetin kontraktor.

4. Shishe termus e personalizuar

- Termusi personalizohet me shkrim ose simbol dhe me ngjyrën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Termus vakum me cilësi të lartë, i prodhuar nga çelik inox, i cili nuk ruan aroma apo shije. Kapaciteti mbajtës: 500 ml. Me sipërfaqe të izoluar të dyfishtë, e cila mban lëngjet të ftohta deri në 24 orë dhe të ngrohta deri në 12 orë. Përmasat: lartësia 26 cm dhe diametri 7.8 cm

7. Kupa xhami Kupë dekorative prej xhami/kristali transparent, me gdhendje 3D sipas dizajnit dhe përmbajtjes së përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Përmasat e kupës: përfaqësisht 23 × 10 × 2 cm. Bazamenti: përfaqësisht 8 × 8 × 5 cm.

6) Prodhim dhe publikim katalogu(reviste) Katalog/reviste I dizenuar ne format elektronik dhe I shtypur :me flete me fotografi me ngjyra,cilesia e I-re ne leter 180 gr,kopertina gjithashtu me ngjyra ne leter 300 gr ,me ngjyra mat dhe me format 21cmx21cm ose 20cmx20cm sipas dhe aktiviteteteve te parashikuara

7) Printime ne forex Printim I materialeve ne forex 10mm I printuar me teknologjine UV sipas dhe aktiviteteteve te parashikuara.

9) Çanta tekstili Çanta me material cope/dok I personalizuar/stmapuar per aktivitetet e parashikuara ne te dyja anet,ne dimensionet 30cmx40cm.Ngjyra e copes/dokut te jete rreth ngjyre bezhe ose pana ne varesi te porositesit.Rrypat e çantes ne domensionet 60x2.5cm gjithashtu ne materailin e çantes me te njejten ngjyre.Ideimi,dizenjimi dhe printimi duhet te jene te perfshira ne cmim dhe te realizohen nga operatori ekonomik.Versioni final duhet te diskutohet paraprakisht me autoritetin kontraktor.

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën. Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti

kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III. 2.3. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që 21 operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.2.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt - prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

III.2.6 Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të pretendimit të paraqitur nga ankimuesi , vlerëson se kërkesa e autoritetit kontraktor për dorëzimin e mostrave të mallrave të specifikuara në dokumentacionin e tenderit përbën një instrument të rëndësishëm për verifikimin e kapaciteteve profesionale, teknike dhe prodhuese të subjekteve që konkurrojnë në procedurën e prokurimit publik. Kjo kërkesë ka për qëllim të sigurojë se ofertuesit posedojnë aftësitë dhe resurset e nevojshme për të prodhuar produktet që përmbushin kërkesat teknike, funksionale dhe cilësore të përcaktuara nga dokumentet e tenderit, duke garantuar kështu që ofruesit e mundshëm të jenë të aftë të përmbushin obligimet kontraktuale në mënyrë të plotë dhe të saktë.

Nga ana tjetër, autoriteti kontraktor, duke iu referuar dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik, ka detyrimin ligjor që të garantojë ofertuesit për qartësinë, saktësinë dhe plotësinë e specifikimeve teknike të paraqitura. Kjo përfshin jo vetëm karakteristikat teknike dhe funksionale të produkteve, *por edhe modele, përmasat, parametrat estetikë, parametrat e performancës dhe çdo tjetër element që mund të ndikojë në përgatitjen e ofertës nga ana e ofertuesve*. Autoriteti kontraktor duhet të sigurojë që specifikimet të jenë të qarta dhe të kuptueshme, në mënyrë që të mundësohet përgatitja e ofertave konkurruese dhe të krahasueshme, duke eliminuar çdo mundësi për keqkuptime ose interpretim të ndryshëm të kërkesave teknike.

Në këtë kuadër, Komisioni vlerëson se kriteri parashikuar nga autoriteti kontraktor, në lidhje me kriterin 2.3.8 “ *Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt e kërkuar sipas specifikimeve teknike, sipas listës më poshtë: Drejtoria e Turizmit 1-Hartë 2-Guidë 3-Gift box Drejtoria e Sherbimeve Sociale, Strehimit dhe Shendetit Publik 1-Roll up me mekanizëm 2-Shishe termusi e personalizua 3- Kupë xhami Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit 1-Katalog/Revistë 2-Printime në forex 3-Çantë tekstili*” janë të drejta dhe të arsyeshme për qëllimet e verifikimit të kapaciteteve të ofertuesve.

Por sidoqoftë, referuar rastit konkret, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur edhe pretendimin: ... “*ose në rast se autoriteti kontraktor e konsideron të domosdoshme dorëzimin e mostrave për të vërtetuar përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike të parashikuara në dokumentat e tenderit, atëherë autoriteti kontraktor duhet tu vërë në dispozicion operatorëve ekonomikë të interesuar file-t grafike për shtyp për mostrat e përcaktuara në kërkesën për kualifikim të pikë 2.3.8 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderi*”, cfare e ben të identifikueshëm dhe arsyeshmërisht të bazuar mbi pasaktësinë e specifikimeve teknike, të cilat sipas këtij të

fundit nuk garantojnë një ide të qartë dhe të drejtë për përgatitjen e ofertës, si dhe nuk lejojnë krahasimin objektiv të mostrave të dorëzuara me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në këto kushte Komisioni, vlerëson se pretendimi I operatorit ekonomik qëndronë dhe përputhen me parimet e transparencës, konkurrencës së barabartë dhe sigurisë juridike, të parashikuara nga LPP.

Për sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor ka detyrimin që, përveç kërkesës për dorëzimin e mostrave, të garantojë saktësinë dhe qartësinë e çdo elementi të specifikimeve teknike, në mënyrë që të respektohen parimet e konkurrencës së barabartë, transparencës dhe krahasueshmërisë së ofertave, duke shmangur çdo avantazh të padrejtë për ofertuesit si dhe duke siguruar një proces prokurimi të drejtë dhe të ligjshëm.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.236, datë 20.04.2024 *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimim në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik *“ALBDESIGN PSP”* sh.p.k, për procedurën e prokurimit *“E hapur, e thjeshtuar”* me nr. REF-82305-04-16-2026 me objekt *“Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale”*, me fond limit 7,454,401.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 28-04-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën për operatori ekonomik *“ALBDESIGN PSP”* sh.p.k, për procedurën e prokurimit *“E hapur, e thjeshtuar”* me nr. REF-82305-04-16-2026 me objekt *“Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale”*, me fond limit 7,454,401.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 28-04-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet e DST sipas konstatimeve të KSHA dhe këtij vendimi për procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik *“ALBDESIGN PSP”* sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar
Gjergj Mersini**

**Anëtar
Anila Malaj**

**Nënkryetar
Fiorent Zguro**

